

VENDIM
Nr.137, datë 18.3.2005

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMEVE PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN
KUNDËR KORRUPSIONIT, 2005**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimeve për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, 2005, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministritë dhe institucionet qendrore të bashkërendojnë punën me institucionet e pavarura dhe organizmat e shoqërisë civile, të përmendura në planin e veprimeve, për zbatimin e masave të përcaktuara në këtë plan.

3. Ministri i Shtetit për Koordinimin dhe grupi i monitorimit antikorrupsion të ndjekin dhe të raportojnë në Këshillin e Ministrave për zbatimin e planit të veprimeve.

4. Ngarkohen ministritë dhe institucionet shtetërore, të përmendura në këtë plan, që çdo gjashtë muaj dhe sa herë që u kërkohet, t'i raportojnë Ministrit të Shtetit për Koordinimin për realizimet respektive, të masave të parashikuara në planin e veprimeve dhe për treguesit statistikorë të rezultateve të arritura.

5. Ngarkohen ministritë dhe institucionet qendrore për zbatimin e këtij plani veprimesh.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano